

## **1. Porti Detar SH.A Sarande menaxhohet nga :**

### **1. Keshilli Mbikeqyres**

1.1 KM zgjidhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomise, ne mbeshetje te Ligjit nr 9901, nr 7926, date 20.04.1995 “Transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne shoqeri tregtare” te ndryshuar, Ligjit nr 9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, dhe statutit te shoqerise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise PDS. Aktualisht ka 3 anetare.

#### **• Qellimi i Keshillit Mbikeqyres:**

- a) Vezhgon dhe mbikeqyr administrimin, zbatimin e politikave tragtare nga drejtoria dhe kontrollon pajtushmerine me kerkesat e Ligjit dhe Statutit. Detyrat e Keshillit Mbikeqyres te percaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronja b,c,c,d,dh,e,e,f,g dhe i te pikes 1 dhe pika 2 e nenit 154 te Ligjit nuk mund ti delegohen drejtorise.
- b) Autorizon administratorin te kryej veprime dhe te realizoje marreveshje te parashikuara nga ligji
- c) Ka te drejte ne cdo kohe te verifikoje dhe te kontrolloje dhe te njihet me dokumentacionin qe e gjykon te nevojshme per permbushjen e detyres
- d) I propozon METE programet e zhvillimi ekonomik afatshkurter,afatmesem dhe afatgjate, kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise, hapjen e veprimtarive ose njesive te reja, shitjen e pasurive qe perbejne aktivet materiale afatgjata te shoqerise.

### **2. Drejtoria ekzekutive, e cila drejtohet nga Drejtori i Pergjithshëm i Portit i cili është përgjegjës për operimin dhe menaxhimin e Portit**

- a) Drejtori organizon dhe mban pergjegjesi per te gjithë veprimtarine e Shoqerise dhe miraton pershkrimin e punes per cdo dege,sektor dhe vend pune
- b) I propozon KM ndryshime ne strukturen organike per te permiresuar mbarevajtjen e punes
- c) Parashikon planet mujore te punes dhe gjithë detyrat qe i dalin drejtorise sipas fushave
- d) Drejton punen per hartimin e projekt-ideve, venien ne zbatim te tyre dhe permiresimin e treguesve ekonomik-financiare te shoqerise
- e) Ben shperndarjen e korrespondences qe i adresohet shoqerise dhe ndjek e kontrollon punen qe behet na kryetaret e degeve,sektoreve dhe punonjesit e vecante per percaktimin dhe dhenien e zgjidhjeve ligjore ne afate te caktuara
- f) Harton, kontrollon dhe firos korrespondencen e pregatitur qe percjell shoqerua, nderton

marredheniet me institucionet e tjera nepermjet tij ose nenpunesit te autorizuar prej tij

- g) Kryen analiza periodike per veprimtarine e shoqerise
- h) Zbaton Kodin e Punes dhe detyrimet qe rrjedhin prej tij
- i) Kerkon zbatimin rigoroz te ligjshmerise nga gjithe punonjesit
- j) Kontrollon dhe merr masa per permiresimin e organizmit te pergjithshem te punes
- k) Miraton kontratat me te tretet dhe cdo akt tjeter qe parashikohet ne detyrat specifike
- l) Drejton me kr/degeve projektet strategjike nderkufitare
- m) Eshte pergjegjes ndaj shtetit, shoqesire dhe ndaj cdo personi te trete per cdo shkelje te ligjit.

### **Aksioneri i vetem**

Aksioneri i vetem i Shoqerise eshte Ministria e Financave dhe Ekonomise. Nga fitimi i shoqerise PDS, aksioneri merr 10% te fitimit ne formen e dividendit.